

VENDIM
Nr. 8, datë 11.5.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 8, DATË 13.2.2017, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR
PROJEKTE, THIRRJA E KATËRT PËR VITIN 2016, TË GRANTIT “INFRASTRUKTURA
VENDORE DHE RAJONALE”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS
VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1/2, që i bashkëlidhet vendimit nr. 8, datë 13.2.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte, thirrja e katërt për vitin 2016, të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I”, bëhen ndryshime sipas tabelës 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Senida Mesi

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Përfaqësuesi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit	anëtar.

Tabela 1

Në tabelën 1/2 që i bashkëlidhet vendimit nr. 8, datë 13.2.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte, thirrja e katërt për vitin 2016, të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I”, projektit nr. 4 i anulohet financimi dhe bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

“Tabela 1/2. Lista e disa projekteve, thirrja e katërt për vitin 2016, me cikël zbatimi 2017–2018”

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2018 (në lekë)
4	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i sheshit publik pranë Mauzoleumit, faza II (anulohet)	0	0
TOTALI			1,415,598,367	425,469,680

Shënim:

1. Anulimi i financimit për këtë projekt bëhet me kërkesë të sekretariatit teknik pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, nr. 509/1 prot., datë 8.5.2018.

2. Numri rendor i totalit të projekteve në tabelën 1/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, ndryshon nga 12 projekte në 11 projekte dhe projektet rinumërohen përkatësisht.